



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane / Ministry of Defence

Nr. 3 / 388 / 2024
Datë: 21 / 06 / 2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr.7/01 Mars 2019), nenit 7 të Ligjit Nr.06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes (Gazeta Zyrtare Nr.01/04 janar 2019), si dhe Vendimin e KPMSHCK Nr. Prot. 2883 datë 31.05.2024, nxjerr:

V E N D I M

1. Anullohet procedura e rekrutimit e shpallur sipas konkursit të datës 29.12.2023 me nr. reference RN00013055 për pozitën *Zyrtar i Lektorimit*.
2. Obligohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore për marrjen e masave për zbatim të këtij vendimi, sipas pikës 1. të këtij vendimi.
3. Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Ky vendim është marr në zbatim të Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, A.nr.489/2024 i datës 31.05.2024, e pranuar në Ministrinë e Mbrojtjes me Nr. prot. 1649/H datë 07.06.2024 me anë të së cilit është bërë anulimi i procedurës së rekrutimit, i shpallur nga MM me datë 29.12.2023 me nr. Ref. RN00013055 për pozitën *Zyrtar i Lektorimit*.

Në piken III të Vendimit të KPMSHCK-së është obliguar Sekretari i Përgjithshëm për marrjen e të gjitha veprimeve të nevojshme me qëllim të zbatimit të vendimit të KPMSHCK-së, për anulim të procedurës së rekrutimit.

Andaj, bazuar në të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë të ushtroj ankesë drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, sikurse parashihet në nenin 27, paragrafin 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 08/L-197 për zyrtarët publik.



Gafurr DUGOLLI

U.D. Sekretar i Përgjithshëm

Vendimi iu dërgohet:

- *KPMSHCK;*
- *Palës fituese të konkursit;*
- *DBNJ;*
- *Arkivit të MM-së.*



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Pranimi / Dorezimi Received / Delivered	31.05	4	with prod year
Organ / Njësia Org / Unit	Nr. Prot Bj. Prot Prot No	Shtup / Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SEDMSHCK	2883/2024		115

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIE E Mbrojtjes - MINISTRY OF DEFENSE	
HYRESE	
Nr. Prot Bj. Prot Prot No	Nr. i Fajeseve Bj. Stranica No. of pages
1649/4	5
07.10.2024	

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.489/2024

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Inspektim Administrativ, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.489/2024 të datës 03.04.2024 të parashtruar nga ankuesja Lumnije Morina me adresë banimi; "Fatmir Ibishi" në Komunën e Gjilanit, kundër Konkursit-Specialist të marrëdhënive me publikun dhe informimin "Zyrtar për Lektorim" të Ministrisë së Mbrojtjes, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 31.05.2024 mori:

V E N D I M

I. Aprovohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.489/2024 e datës 03.04.2024 e parashtruar nga ankuesja Lumnije Morina.

II. Shfuqizohet Njoftimi për rezultatet përfundimtare i datës 05.09.2023 i Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore, ndërsa Anulohet në tërësi procedura e rekrutimit e shpallur sipas konkursit të datës 29.12.2023 me numër të Referencës RN00013055 për pozitën "Zyrtar i Lektorimit" në Ministrinë e Mbrojtjes.

III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes që të ndërmerr të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën II të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja Lumnije Morina, e cila sipas shkresave të lëndës është kandidat në procedurën e rekrutimit për pozitën "Zyrtar për Lektorim" në Ministrinë e Mbrojtjes ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.489/2024 me numër protokolli 1819/2024, kundër procedurës së rekrutimit për pozitën "Zyrtar për Lektorim"

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se ka pasur parregullsi në testim me shkrim me arsyetimin se gjate testit me shkrim iu është thënë nga anëtarët e komisionit se kemi kohe për me shume se një ore për mbajtën e testit me shkrim por nuk i kane njoftuar se duhet te kërkojnë kohen shtese pasi qe te behet një ore dhe për shkak te mos informimit te sakte nuk ka arritur qe te përfundojë testin ne kohen e sakte dhe nuk ka marr pikët e nevojshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 08.04.2024 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Mbrojtjes. Ndërsa me datë 14.05.2024, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën A.nr.489/2024 të datës 03.04.2024 të parashtruar nga ankuesja; Kopjen e letërnjoftimit te ankueses; Konkursin e datës 29.12.2023; Kërkesën për përgjigje ne ankesë e datës 08.04.2024; Përgjigje ne ankesë e datës 14.05.2024; Lista e aplikantëve; E-malin e datës 20.02.2024 nga J.B për G.D; Vendimin e datës 12.02.2024; Renditjen përfundimtare te kandidateve; Njoftimin e datës 28.02.2024; Njoftimin e datës 15.03.2024; Akt emërimit e datës 29.04.2024; Aplikacionin e ankueses te datës 16.01.2024; Diplomën me numër 2320; Diplomën me numër 648; Certifikatne e vitit 2006; Çertifikatën e datës 09.07.2009; Referenca e datës 30.08.2010; Referenca e datës 12.10.2016; Certifikata mbi dënimet penale e datës 11.01.2024; E-mailin e datës 23.05.2024 me prova e bashkangjitura shkresë; Kërkesë e datës 22.05.2024; Aplikacioni i datës 24.01.2024 i kandidates D.G me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni i datës 04.01.2023 i kandidates D.G me dokumentet e bashkangjitura; Diplomë e datës 09.07.2012; Diplomë e datës 29.08.2016; Diplomë e datës 12.03.2019; Pasqyrë e llogarisë së Trustit për kandidaten M.D; Kopje e letërnjoftimit e kandidates M.D; Çertifikatë mbi dënimet penale e datës 04.01.2024.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankueses Lumnije Morina , e parashtruar me datë 03.04.2024 është e bazuar, *sepse*:

Nga analizimi i provave të lëndës rezulton se, Ministria e Mbrojtjes , më datë 29.12.2023 ka shpallur Konkursin e jashtëm për pranim për grupin *Specialist të Marrëdhënieve me Publikun dhe Informimin*, respektivisht pozitën e punës "Zyrtar për Lektorim" me numër të referencës RN00013055. Rrjedhimisht, sipas Njoftimit për Rënditje Përfundimtare të Kandidateve, ankuesja është përfshirë në fazat e procedurës, konkretisht listën e ngushtë dhe testin me

shkrim, mirëpo nuk ka arritur piket e nevojshme por vetëm 32 pikë që të kalojë dhe në fazën e intervistimit, ndërsa e njëjta pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ka parashtruar ankesë në Këshill.

Kolegji i Këshillit përpara se të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankesës, në mbështetje të dispozitave të nenit 86 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”* si duke marr për bazë kompetencën lëndore, fillimisht analizoi shpalljen e konkursit si dhe aplikacionin e kandidatës fituese.

Sipas shkresave të lëndës, rezulton se sipas konkursit të datës 29.12.2023 për grupin *Specialist të Marrëdhënieve me Publikun dhe Informimin*, pozita e punës *“Zyrtar për Lekturim”* kriteret e konkursit kanë qenë: *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve Gjuhë dhe letërsi shqipe; dhe Përvoja e punës së kërkuar: Së paku një (1) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Duke marr për bazë dispozitat e nenit 103 paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet: *“Me kusht që të mos jenë në kundërshtim me këtë ligj dhe deri në miratimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij, përshtatshmërisht vlejnë aktet nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik.”* dhe mbi këtë bazë me qëllim të vlerësimit nëse kriteret e konkursit kanë qenë në pajtueshmëri me ligjin material, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Shtojca Nr. 2: Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm, ku sipas renditjes me numër 10 për **Grupin Specialist i Marrëdhënieve me Publikun dhe Informimin**, janë përcaktuar kriteret e kualifikimit arsimor si në vijim: *Gazetari/Shkenca Komunikimi, Gjuhë dhe Letërsi, Marrëdhënie me Publikun, Marketing.*

??? Po ashtu, Kolegji i Këshillit pasi që konstatoi se sipas Njoftimit të datës 15.03.2024 kandidatja e suksesshme rezulton të jetë M.M me gjithsejtë 78.8 pikë, analizoi aplikacionin e saj dhe gjeti se e njëjta posedon Diplomën e datës 29.08.2016 përmes së cilës dëshmohet se me datë 04.07.2016 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Filozofik-Dega e Gjuhës Shqipe në kuadër të Universitet të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe po ashtu posedon Diplomën e datës 12.03.2019 përmes së cilës dëshmohet se me datë 01.03.2019 ka përfunduar studimet master në Fakultetin Filozofik-Programi i Gjuhës Shqipe në kuadër të Universitet të Prishtinës “Hasan Prishtina”, ndërsa Kolegji i Këshillit konstatoi se kandidatja e suksesshme në aplikacionin e saj **nuk ka bashkangjitur edhe kopjet e dëshmisë së punësimit sikurse ka qenë e përcaktuar në pikën 5 të konkursit të shpallur të datës 29.12.2023** respektivisht një çështje e tillë përcaktohet edhe me dispozitat e nenit 6 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Rregullores NR. 15/2023 Për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: *“2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit;”* ndërsa në rrethanat e rastit konkret është e paqartë se si Komisioni Pranimit ka mund ta bëjë verifikimin paraprak në kuptim të nenit 7 të së njëjtës rregullore nëse ankuesja e ka plotësuar kriterin e përvojës së punës sipas konkursit *“Së paku një (1) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës*

së lirë të punës”, pasi që pasqyra e trustit e kandidates së suksesshme nuk është dokument përmes së cilës mund të bëhet verifikimi i natyrës së marrëdhënies së punës apo pozitës që ka mbajtur e njëjta e punësuar në sektorin privat, respektivisht pasqyra e trustit është obligative me qëllim që të legjitimohen shkresat e sjella nga kandidatët në procedurë të pranimi që përvojën e punës e paraqesin nga sektori privat, mirëpo në asnjë rrethanë pasqyra e trustit nuk e zëvendëson vërtetimin apo kontratën e punës me qëllim të dëshmisë së përvojës së punës në sektorin privat.

Prandaj nga se u tha si më lartë dhe pas konstatimit të dhënë si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit meqenëse ka konstatuar se të gjeturat përbëjnë shkelje esenciale të dispozitave ligjore për Shërbimin Civil, respektivisht shkelje të kriterëve për pozitë e punës të përcaktuara sipas Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe ka ardhur në përfundimin se nuk është e nevojshme të shqyrtohen pretendimet ankimore të ankuesit, ngase të gjeturat e tjera eventuale nuk do të kishin asnjë relevancë juridike në këtë procedurë vendimmarrëse, ngase konkursi i shpallur i datës 29.12.2023 është bërë në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 paragrafi 1 dhe nenit 37 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “7.1. Pranimi në detyrë i nëpunës/it civil, nëpunës/it së shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it së artit dhe kulturës, si dhe nëpunës/it teknik dhe mbështetës, bazohet në parimin e meritës, e mundësive të barabarta, profesionalizmit dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë gjinor dhe të komuniteteve, përmes një procedure të hapur dhe konkurruese; 37.2. Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil është ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohet ndryshe vetëm në rastet kur parashihet shprehimisht në këtë ligj.” pasi kriteret e përcaktuara sipas konkursit të datës 29.12.2023 nuk janë sipas Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, sikurse Komisioni i Pranimi me rastin e përfshirjes së kandidates së suksesshme në listën e ngushtë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 të Rregullores NR.15/2023 Për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil pasi që ë njëjta nuk e ka mbështetur aplikacionin e saj me dokumentet e nevojshme të punësimit sikurse përcaktohej me pikën 5 të konkursit të shpallur të datës 29.12.2023 dhe nenit 6 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Rregullores NR. 15/2023 Për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil dhe mbi këtë bazë konkursi i shpallur (pranim) i datës 29.12.2023 për pozitën “Zyrtar për Lekturim” me numër të Referencës RN00013055 është anuluar sikurse në dispozitiv e këtij vendimi, ndërsa ankesa e ankueses është aprovuar vetëm mbi bazën e të gjeturave si më lartë ngase pretendimet e së njëjtës nuk janë shqyrtuar për shkak së të njëjtat nuk kishin relevancë vendimmarrëse në këtë procedurë, respektivisht nuk do të mund ta ndryshon natyrën vendimmarrëse.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër *A.nr.489/2024*

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Inspektim Administrativ

Malsore GASHI BAJRAKTARI



Vendimi i dërgohet:

- *Ankueses Lumniqe Morina;*
- *Udhëheqësit të Personelit të Ministrisë së Mbrojtës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*